

**KONKURS PËR NDARJEN E ÇMIMIT PËR PËRKTHIM MË TË MIRË STUDENTOR
DHE REZIDENCË STUDENTORE PËR PËRKTHIM LETRAR
"BABILON– Gjenerata e re" 2024**

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM: 27 mars 2024

Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Fakulteti Filologjik "Blazhe Koneski" – Shkup kanë kënaqësinë të shpallin **Konkursin për Çmimin për Përkthimin më të Mirë të Studentëve dhe Rezidencën Studentore për Përkthim Letrar "Babilon– Gjenerata e re" 2024.**

Thirrja u drejtohet të gjithë studentëve universitar (jo më të vjetër se 27 vjeç), të cilët në kohën e aplikimit janë regjistruar të paktën në vitin e tretë të studimeve në ndonjë prej fakulteteve në vend. **Kandidatët duhet të aplikojnë për konkursin me përkthim nga një prej 24 gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian, në ndonjë nga gjuhët që fliten në vend.**

Konkursi në vetvete përbëhet nga dy faza, si më poshtë:

- ✓ **Rezidenca Studentore për Përkthim Letrar, e cila do të mbahet nga 17 deri më 21 prill 2024 në fshatin Radozhdë, Strugë.** Përmes një programi të menduar me kujdes, rezidenca do të ofrojë një sërë sesione për ndërtimin e aftësive për përkthim në aspektet e tyre të ndryshme, të udhëhequra nga mentorë, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një mbindërtim profesional jashtë-mësimit, si dhe të inkurajohet cilësia gjatë përkthimit të veprave letrare nga gjuhët evropiane në gjuhët që fliten në vendin tonë.

Shpenzimet për rezidencën, duke përfshirë transportin dhe akomodimin me pansion të plotë, do të mbulohet plotësisht. Akomodimi do të organizohet në ambiente private (1/2 dhe 1/3 suita).

Programi i detajuar i rezidencës, si dhe të gjitha informacionet logjistike do t'u dërgohen pjesëmarrësve pas mbylljes së thirrjes për aplikim.

- ✓ **Pas përfundimit të rezidencës, kandidatët do të punojnë në përkthimin në kuadër të kombinimit të tyre gjuhësor, me të cilin do të konkurrojnë në mënyrë anonime për çmimin për përkthimin më të mirë të studentëve.** Përkthimi parashikohet të bazohet në një fragment nga titulli të zgjedhur nga lista e titujve të prozës në gjuhët zyrtare përkatëse të BE-së, të cilat kandidati/kandidatja do t'i përkthejë në gjuhën e zgjedhur të synuar, që flitet në vendin tonë. Lista, të cilën kandidatët do të marrin në fund të rezidencës, do të përbëhet nga vepra në prozë që ende nuk janë përkthyer në gjuhët lokale. Përkthimi duhet të jetë i gjatë 3.000 – 5.000 fjalë. Përkthimet e paraqitura duhet të jenë punë individuale e kandidatit/kandidates; përkthimet e përbashkëta nuk do të pranohen.

Juria që do të vlerësojë përkthimet do të përbëhet nga përkthyes të etabluar, profesorë universitarë, shkrimtarë, etj. - me përjashtim të mentorëve të rezidencës, me qëllim garantimin e transparencës gjatë dhënies së çmimit.

Udhëzime të hollësishme për formatin dhe mënyrën e dorëzimit të përkthimeve do të jepen pas përfundimit të rezidencës.

Pjesëmarrja në rezidencë nënkupton automatikisht detyrimin për paraqitjen e e përkthimit nga studenti/studentja, me të cilin do të kandidojë për çmimin.

Gjuha e punës në rezidencë për përkthim letrar do të jetë gjuha maqedonase.

Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në rezidencë është 15 studentë. Aplikantët do të njoftohen në fillim të prillit për përgjigjen e aplikimit të tyre.

Korniza kohore

Afati i fundit për aplikim: **27 mars 2024**

Ngjarja në rezidencë: **17 – 21 prill 2024**

Afati i fundit për dorëzimin e përkthimeve: **30 korrik 2024**

Ceremonia e ndarjes së çmimeve është planifikuar për Ditën Evropiane të Gjuhëve, 26 shtator 2024.

APLIKIMI:

- **Formulari i plotësuar për aplikim**

- **Biografi e shkurtër**

- **Përkthim i shkurtër për pranim** të një fragmenti nga një vepër në prozë, me gjatësi prej 500 - 1,000 fjalë, të kombinimit gjuhësor për të cilin ka aplikuar kandidati/kandidatja (p.sh. nga italisht në maqedonisht). Përkthimi duhet të bëhet drejtpërdrejt nga teksti i prozës në gjuhën burimore dhe të dorëzohet vetëm në gjuhën e synuar. Përkthimi pranues duhet të përmbajë gjithashtu informacion në lidhje me botimin burimor dhe nga cila gjuhë është përkthyer (p.sh. përkthimi nga origjinali në gjuhën angleze, Banville, John. The Sea. [2. Ed.], Alfred A. Knopf, 2007, p. 190-195).

- **Një deklaratë e nënshkruar** nga kandidati që, me aplikimin dhe pjesëmarrjen në rezidencë, ai/ajo merr përsipër të marrë pjesë në Çmimin *BABILON – Gjenerata e re* 2024, duke paraqitur përkthimin e vet, si dhe se ai/ajo pajtohet me të gjitha kushtet e konkursit dhe rezidencës.

- **Kopje digjitale e letërnjoftimit**

Dokumentet duhet të dorëzohen përmes Google formularit të mëposhtëm, jo më vonë se 27 mars 2024: <https://forms.gle/uhtWc8RrwAdFGUQM8>

Pyetjet në lidhje me konkursin mund të dërgohen në adresën e mëposhtme: babylonnewgeneration@euhouse.mk .

- Kandidatët/kandidatet e paraqitura duhet të jenë shtetas të Maqedonisë së Veriut.
- Të afërmit dhe/ose miqtë e organizatorëve ose anëtarëve të jurisë nuk kanë të drejtë të marrin pjesë.
- Vendimi i jurisë është përfundimtar. Kandidatët mund të marrin komente për vërejtjet e jurisë mbi përkthimet e paraqitura pas dhënies së çmimeve.
- Juria do të formohet në përputhje me kombinimet gjuhësore përkatëse.
- Juria rezervon të drejtën të mos japë çmim.
- Aplikimi për konkurs nënkupton pranimin e të gjitha kushteve në të cilat do të zhvillohet rezidenca dhe përzgjedhja pasuese e përkthimit më të mirë.

Shpërblimi do të përbëhet nga qëndrimi studentor i lidhur me përkthim (në lartësi prej 1.000 euro) dhe publikim të përkthimit që është shpërblyer me çmimin e parë në Antologjinë vjetore të fakultetit filologjik „Blazhe Koneski “ – Shkup.

Më shumë informacion mund të gjendet në internet faqet e mëposhtme:

https://eeas.europa.eu/delegations/republic-north-macedonia_en

<https://flf.ukim.mk/>

<https://www.euhouse.mk/>

APLIKACIONI

Emri dhe mbiemri i kandidatit/es:

Numri i telefonit për kontakt:

Adresa e e-mailit për kontakt:

Universiteti, fakulteti dhe viti i studimit:

Gjuha burimore e përkthimit:

Gjuha e synuar e përkthimit:

Ju lutemi shënoni vërejtje plotësuese, nëse është e nevojshme:
